



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 354/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare – Adriana Hodžić, në Mitrovicë Veriore, me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, paautorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Mitrovicën e Veriut, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 11.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hidhet** e palejuar ankesa A.nr. 354/2021 e datës 08.02.2021, e paraqitur nga Instituti Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj subjektit politik Iniciativa Qytetare – Adriana Hodžić, me seli në Komunën e Mitrovicës Veriore.

## A r s y e t i m

Me datë 08.02.2021, Instituti Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi ashtu që me datë 07.02.2021, në rrugën Krajl Petar I- në Mitrovicën Veriore është mbajtur një tubim publik me diskutim dhe shpalosje të programit me qytetar nga subjekti politik Iniciativa Qytetare – Adriana Hodžić i cili tubim nuk ka qenë i paralajmëruar në KKZ, përkatësisht tek Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik Iniciativa Qytetare – Adriana Hodžić është në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore 13/2013, respektivisht nenin 7 par.1 dhe nenin 2 par.2 në lidhje me nenin 4 par.2 të kësaj rregulloreje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Me dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, përcaktohet se: *“Nëse ZLKK-ja, ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës hasin në tubim publik të paautorizuar, ata duhet të informojnë PZAP për hollësitë e tubimit publik: për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik*

*që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik".*

Paneli vlerëson se nga dispozita e lart cituar, rezulton se të drejtën për ta informuar PZAP, lidhur me rastet e mbajtjes së tubimeve elektorale-publike pa autorizim, gjatë fushatës zgjedhore, e kanë vetëm ZLKZ-ja ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës, e që në këtë rast ankesa është paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e cila nuk ka legjitimitet për të paraqitur ankesa të kësaj natyre, andaj si e tillë është hedhur e pa lejuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2015 të PZAP-it, nenin 6 paragrafi 4, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.354/2021 më datë 11.02.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
Adnan Konushevi



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LPZ-së.